

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI
DREJTORIA E HETIMIT ADMINISTRATIV

Nr. 932/ Prot.

Tiranë, më 25.06.2024

Lënda: Njoftim dhe kërkesë për informacion.

SHOQËRISË TOP ALBANIA SH.A
TOP ALBANIA RADIO
EMISIONI "NDRYSHE"

Sheshi Italia, Arena Center, Hyrja D, Zona e zyrës nr."DC", nivel L+3
Tiranë

Z. BURAJ KAPEXHIU

Universiteti European i Tiranës
Kompleksi Xhura, Rruga "Xhanfize Keko"
Tiranë

Z. ADI POJANA

Moderator në Emisionin "Ndryshe", Top Albania Radio
Sheshi Italia, Arena Center, Hyrja D, Zona e zyrës nr."DC", nivel L+3
Tiranë

Z. SALSANO RAPI

Moderator në Emisionin "Ndryshe", Top Albania Radio
Sheshi Italia, Arena Center, Hyrja D, Zona e zyrës nr."DC", nivel L+3
Tiranë

Z. VISJAN UKCENAJ

Moderator në Emisionin "Ndryshe", Top Albania Radio
Sheshi Italia, Arena Center, Hyrja D, Zona e zyrës nr."DC", nivel L+3
Tiranë

Për dijëni:

QENDRA "AMAD"

Rruga: "Nikolla Jorga", Blloku 50-vjetori, hyrja 4
Tiranë

Mbështetur në Ligjin nr. 10221/2010 "Për Mbrojtjen nga Diskriminimi", të ndryshuar¹, pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi² është paraqitur ankesa nr. 133 Regj., datë 18.06.2024, nga Qendra "AMAD" kundër Emisionit "Ndryshe", në Top Albania Radio, z. Bujar Kapexhiu, i ftuar në Emisionin "Ndryshe", z. Salsano Rapi, moderator në Emisionin "Ndryshe", z. Adi Pojana, moderator në Emisionin "Ndryshe" dhe z. Visjan Ukcenaj, moderator në Emisionin "Ndryshe", në të cilën pretendohet për diskriminim për shkak të gjinisë.

Sipas shpjegimeve të dhëna në formularin e ankesës, subjekti ankues informon se: *"I ftuar në pjesën e dytë të emisionit "Ndryshe", në Top Albania, publikuar më datë 12 qershor 2024, të moderuar nga Salsano Rapi, Adi Pojana dhe Visjan Ukcenaj, ka qenë i ftuar regjisor, skenarist, karikaturist dhe aktori i mirënjohur shqiptar z. Buraj Kapexhiu.*

Z. Kapexhiu shprehet "Femër që shkruan humor nuk ka sepse humori është privilegj i të mençurve." Moderatorët dhe i ftuari shpërthejnë të ngazëllyer në të qeshura dhe Adi Pojana i shtrëngon dorën për këtë deklaratë z. Kapexhiu.

Vijon elaborimi i z. Kapexhiu, se ka shumë barcaleta për femrat që i sajojnë meshkujt dhe shumë barcaleta për meshkujt që i sajojnë prapë meshkujt sepse "Femrat nuk kanë kapacitet për të sajuar barcaleta". E sërish nga moderatorët dhe të ftuarit deklarata shoqërohet me të qeshura të ekzaltuara. Titulli i publikimit është "Femrat nuk kanë kapacitet për të sajuar barcaleta", Bujar Kapexhiu lë moderatorët pa fjalë", ndërkohë që duket qartazi se këto deklarata mizogjene dhe diskriminimi gjinor ndaj femrave kanë gjetur hapësirën mediatike, mjedisin dhe nxitjen të ky panel dhe emision. Titulli i publikimit me frazën "lë moderatorët pa fjalë" thjesht kërkon të zbehë përgjegjësinë mbi moderatorët, ndërkohë që veprimet si të qeshurat dhe shtrëngimi i dorës ishte mbështetje e këtyre deklaratave diskriminuese e mizogjene, në përforcim të disa stereotipave gjinore negative dhe të gabuara për shoqërinë. Këto deklarata kanë marrë zë dhe nga përhapja në platforma të ndryshme në rrjetet sociale ku Top Albania Radio ka publikuar insertin në fjalë."

Subjekti ankues, kërkon nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi:

- Konstatimin e diskriminimit dhe marrjen e sanksioneve përkatëse ndaj emisionit, platformës mediatike; z. Bujar Kapexhiu, i ftuar në emision dhe artikules i deklaratave të forta mizhogjinie; z. Adi Pojana, moderator i emisionit "Ndryshe" në Top Albania Radio, i cili mbështet në transmetim me shtrëngimin e dorës/gjestikulacion e të qeshura deklaratat diskriminuese të z. Bujar Kapexhiu; z. Salsano Rapi, moderator i emisionit "Ndryshe" në Top Albania Radio, i cili mbështet në transmetim me gjestikulacion e të qeshura deklaratat diskriminuese të z. Bujar Kapexhiu; z. Visjan Ukcenaj, moderator i emisionit "Ndryshe" në Top Albania Radio, i cili mbështet në transmetim me gjestikulacion e të qeshura deklaratat diskriminuese të z. Bujar Kapexhiu.
- Marrjen e masave për të ndaluar dhënien e hapësirës në media për inkurajimin e diskriminimit gjinor dhe mizogjenizmit si dhe të mos ketë element diskriminues në vijim, e për më tepër të mos

¹ Në vijim referuar me akronimin LMD.

² Në vijim referuar si Komisioneri.

u përforcohet e amplifikohet zëri nga regjia e montazhit duke i publikuar në platformat online (Youtube, Instagram etj.).

Gjatë aktivitetit të tij, Komisioneri ka dënuar fuqimisht përdorimin e gjuhës fyese dhe intolerancës ndaj një komuniteti të caktuar, nga ana e individëve që bëjnë pjesë në jetën publike. Gjatë trajtimit të rasteve të ngjashme, Komisioneri ka kërkuar nga subjektet ndaj të cilëve është paraqitur ankesa, si masë rregulluese ndjesë publike në mënyrë që situata diskriminuese e pretenduar të marrë zgjidhjen e duhur e të mos përsëritet më në të ardhmen.


Diskriminimi për shkak të “gjinisë” është shkak i mbrojtur nga LMD, në të cilin në nenin 3/1, të tij, parashikohet se: “ *“Diskriminim” është çdo dallim, përjashtim, kufizim apo preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim apo pasoje pengesën apo bërjen të pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe nga ligjet në fuqi”*.

LMD ka parashikuar në nenin 7/1 “*Çdo veprim ose mosveprim i autoriteteve publike ose i personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe të tjera personash, përbën diskriminim”*.

Bazuar në nenin 32/2, të LMD-së, “*Të gjitha institucionet publike dhe subjektet private janë të detyruara të mbështesin Komisionerin, duke i dhënë informacionin që i nevojitet dhe duke i garantuar aksesin në informacionin në përmbushjen e detyrave të tij”*, kërkojmë nga ana juaj që të paraqisni parashtrime me shkrim lidhur me gjuhën e përdorur në emision, si dhe çdo shpjegim, informacion apo dokumentacion provues, që ju do e gjykoni të arsyeshëm dhe do të ndihmonte në sqarimin e plotë të kësaj çështjeje.

Në përmbushje të sa më sipër citohet, Komisioneri kërkon nga ana e Top Albania Radio, të depozitojë në cilësi prove videon/regjistrimin e emisionit sipërcituar.

Duke besuar në bashkëpunimin tuaj,

KOMISIONERI

Robert GAJDA

11

12

13